

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SUAR FURNISH” SHPK

Ortaku i vetëm themelues:

- **Z. Gentjan Zifle**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 25.05.1988, lindur në Ballsh dhe banues në Tiranë, rruga “Shyqyri Brari”, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes së Identitetit Nr ID I80525176G

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 17.10.2022, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “SUAR FURNISH”.
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “SUAR FURNISH”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “SUAR FURNISH” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Rruga “Shyqyri Brari”, Pallati Firma Flag, Kati i parë, Hyrja e parë, Nr.2, Nr i pasurisë 8/450-N13, Kodi Unik 8270082179, Zona Kadastrale 8270, Njesia Bashkiake nr 12, Tiranë.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është: Import-Eksport, tregetim me shumicë dhe pakicë të mobiljeve, elementeve të drurit. Riparim mobiljesh, dhenie mobilje me qera. Tregtim dhe Transport i lëndës drusore, të përpunuar dhe të papërpunuar. Tregtim të ndryshme mobilje, orëdi etj. Të merret me promovimin e shkëmbimeve tregtare nga Shqipëria për jashtë dhe nga jashtë për në Shqipëri. Prodhimin dhe tregtimin e produkteve, me baze materiale të ndryshme, për të gjithë sektorët e ekonomisë. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve tregtarë, konfeksione. Blerje pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, t'i marrë ose t'i lëshojë me qera, të marrë tenderin e tyre. Tregtim paisjesh elektro-shtëpiake, elektrike, higjienosanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati etj. Tregtim materialeve ndërtimi të lëndës të para, import eksport. Aktivitet konsultimi, keshillimi, zhvillimi biznesi dhe trajnimi. Veprimtari ndërmjetesimi si agjenci ose komisioner, në operacione të karakterit tregtar. Marrja pjesë në tendera dhe ankande si dhe kryerja e shërbimeve që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë së saj. Tregtim i materialeve të ndryshme me shumicë dhe pakicë në format të parashikuara dhe të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Tregtim me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vete shoqërisë si dhe të tjerëve. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit. Mund të hyjë në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushat e përmendura më sipër.



NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "SUAR FURNISH" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "SUAR FURNISH" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "SUAR FURNISH" SHPK është 100.000 (njqind mije) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetem Z. Gentjan Zifile.

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është Z. Gentjan Zifile.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "SUAR FURNISH" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

GENTJAN ZIFILE

Gentjan Zifile 